



Adresa: rr. "Adem Jashari", pn, vvvqjilani-komuna.org; zip_qjilan@hotmail.com, tel. 028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 15. 22, dhe 24 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.14/ 2003 dhe nenit 11. par. 1. pika 2. të Ligjit për ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106, nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues, nr. 41-02/05 prej 04.mars/2004, nenit 38.pika1.2, 1.3. dhe 1.4. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në mbështetje të nenit 3. dhe 4. të Vendimit të KK-ës Gjilan, nr. 01-8030/020, dt. 04.10.2002, për miratimin e Planit Detaj Urbanistik: "Zona Perëndimore-Qarku" e Qytetit të Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më:06.03.2013, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Zgjidhjes Urbanistike të një pjese të PDU: "Zona Perëndimore-Qarku"

I.

Me këtë Vendim, miratohen kushtet për zgjidhjen urbano- arqitektonike për pjesën e Planit Detaj Urbanistik: "Zona Perëndimore-Qarku" në tekstin e mëtjem: (ZU-PDU-"Qarku") të Qytetit të Gjilanit, i cili përfshinë parcelat, përkatësisht pjeët e parcelave: nr. 613, 614-2, dhe 614-3, Vendi i quajtur: "Petigovc" ZK Gjilan, në tërësi sipas paraqitjes grafike në ortofoto dhe plan situacional, i cili është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

II.

Me Zgjidhjen Urbanistike nga pika 1. e këtij vendimi jan harmonizuar zhvillimet e bëra sipas Planit të vjetër Detaj Urbanistik nga viti 1984, disa zhvillime të bëra sipas PDU: "Zona Perëndimore-Qarku" nga viti 2002, duke ua përshtatur nevojave dhe mundësive reale për të arritur kushte optimale të zhvillimit, organizimit, rregullimit të hapësirës, ndërtimit dhe shfrytëzimit racional të objekteve të infrastrukturës teknike komunale, me qëllim të krijimit të kushteve për qasje, qarkullim dhe lëvizshmëri të lirë dhe të papenguar në objektet ekzistuese dhe zhvillimet në perspektivë.

III.

Zgjidhja Urbanistike nga pika 1. e këtij Vendimi, është hartuar nga Sektori për Planifikim i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilani dhe e njëta nënkupton caktimin e kushteve të lokacionit për ndërtimin e ndërtesave individuale dhe objekteve tjera të infrastrukturës teknike komunale.

IV.

Patlujtshmëritë – pjesët e Parcelave dhe objektet e përfshira me këtë Vendim, të cilat jan të destinuara për rregullimin e hapësirës dhe dhe ndërtimin e objekte publike- të infrastrukturës teknike komunale, e që nuk janë pronë Komunale, shpallen me Interes të Përgjithshëm Publik, në tërësi sipas ligjit në fuqi.

V.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, që kushtet e lokacionit nga propozim zgjidhja Urbanistike ta inkorporojë në Planin Rregullues Urban: "Qarku ", i cili është në process të hartimit.

VI.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan, që në vështrim të pikës IV. të këtij Vendimi, të inicojë dhe zbatoj proedurën e shpronësimit të tokës dhe kompenzimit të objekteve të përfshira me këtë vendim.

VII.

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

VII.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

VIII.

Me hyrjen në fuqi të këtij propozim vendimi, pushon të vlejë pjesa e Planit dhe aktet tjera që burojnë nga ai Plan, për hapësirën e përfshirë në pikën I. të këtij propozim Vendimi.

A r s y e t i m
i
propozim Vendimit për miratimin e Zgjidhjes Urbanistike
të një pjese të PDU "Zona Perëndimore-Qarku"

Në vazhden e realizimit të Planit Detaj Urbanistik: "Zona Perëndimore-Qarku", krijimin e kushteve sa më optimale dhe paisjes së qytetarëve me leje ndërtimi e posaqërisht ndërtimit të objekteve të infrastrukturës teknike komunale-hapjes së rrugëve në këtë lokacion , është paraqitur nevoja e riorganizimit të kësaj hapësire.

Ndërhyrja në planin ekzistues është pasojë e mospërputhjes së Planeve të vjetra urbanistike, (!984), në bazë të të cilave janë lëshuar Leje të ndërtimit dhe janë ndërtuar objekte të banimit individual banimor sipas atij plani, por nuk është realizuar procedura e shpronësimit dhe ndërtimit të objekteve të infrastrukturës komunale-rrugëve, e të cilat me rastin e miratimit të PDU:" Qarku" nga viti 2002, nuk janë harmonizuar, kështu që kanë qenë pengesë edhe për realizimin e planit ekzistues sipas formës së parcelave kadastrale dhe përmbajtjeve të infrastrukturës teknike komunale, hapjes së dhe ndërtimit të rrugëve publike dhe përmbajtjeve tjera përcjellëse.

Sipas përpunimit të zgjidhjes urbanistike, nga parcela nr. 613 në sip. prej gjithësej: 8280m², duhet të shpronësohet, s= prej 779m², në të cilën gjindet edhe objekti banimor i papërfunduar, e i cili duhet të kompenzohet, ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes destinohet për ndërtim-banim individual.

Poashtu me këtë zgjidhje urbanistike preken edhe pjesët e parcelave nr. 614-2 dhe 614-3 (pronë e Familjes Sopi) e të cilat në procedurën e shpronësimit do të ndrrohen me qëllim të kompletimit të trojeve dhe rrugës publike me qëllim të funksionalizimit të tyre.

Me riorganizimin e hapësirës të lokacionit konkret, është tentuar që në bashkpunim dhe mirëkuptim me pronarët e parcelave të ofrohen zgjidhje sa më racionale edhe në aspektin financiar edhe në aspektin funksional si dhe krijimin e kushteve për shpronësimin, hapjen dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës teknike komunale si dhe komunikimin e lirë dhe të papenguar e sigurt të banorëve të këtij lokacioni, duke ju mundësuar edhe ndërlidhje me pjesët tjera për rreth dhe më gjërë.

Ndaj, Ju propozojmë që pas shqyrtimit të propozim vendimit me paraqitjen grafike, të njejtin të ia rekomandoni KK-ës Gjilan për miratim

Shkurt / 2013

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
G J I L A N